



Gruaja përtej klikimeve dhe pëlqimeve

Nga Mirela Sula

Kisha dëgjuar për Linda Ramën shumë kohë më parë. E ndiqja me admirim për punën e jashtëzakonshme që bënte si aktiviste për çështjet e të drejtave të njeriut dhe të shoqërisë civile, sidomos për ato që përqendroheshin te të drejtat e fëmijëve dhe të grave. Përpara sesa të bëhej bashkëshortja e kryeministrit shqiptar, ajo kishte investuar shumë në zhvillimin e saj profesional dhe kishte arritur shumë në jetë. Një grua që ishte model për shumë të tjerë, veçanërisht, në një vend të vogël si Shqipëria, e cila ka qenë e izoluar për shumë vite nën regjimin komunist. Në këtë intervistë ekskluzive për revistën “Global Woman”, Linda Rama ndan historinë e saj të thellë, që është kaq frymëzuese. Ndërsa flisja me të, ndihesha sikur nuk ishte vetëm historia e saj, por ajo e shumë grave shqiptare që kanë kaluar përvojën e asaj periudhe.

Përtej fjalëve dhe mesazhit të saj, mund të shihja veten, nënën time dhe shumë të tjerë që mund të gjejnë veten kur ta lexojnë këtë. Një grua e fuqishme si Linda Rama, që, në të njëjtën kohë, është kaq modeste dhe e përlur, mund të na tregojë të gjithëve se të qenit e ndjeshme është ndonjëherë magjia ku mund të gjejmë fuqinë që na duhet. Jam shumë e nderuar dhe e privilegjuar që ndaj këtë intervistë me komunitetin e “Global Woman” dhe mbarë botën, sepse kjo më jep mundësi të shfaq pak nga realiteti i vendit tim në të shkuarën, të tashmen dhe në atë që mund të jetë.

Keni lindur në një vend të vogël, i cili ka qenë i izoluar për një kohë të gjatë. Si ka ndikuar kjo në rrugëtimin tuaj si grua?

Madhësia e vendit ku lind, për mua, nuk matet me kilometra katrorë, po me ngjarjet e kohës që jeton. Në këtë sens, unë, si i gjithë brezi im, pata fatin të jetoj ngjarjet e jashtëzakonshme që ndanë historinë e Shqipërisë në dy pjesë krejt të ndryshme: totalitarizmin komunist, me izolimin ekstrem edhe nga vetë të ngjashmit tanë ne Lindjen Bolshevike dhe demokracinë në formim, pas rënies së mureve të izolimit, ku u gjendëm të mbushur me ëndrra përballë hendekut të pamatë, që na ndante nga bota e ëndrrave tona.

Imagjini pak vetëm faktin që, deri në rënien e mureve, brenda të cilave kishte kaluar fëmijëria dhe jeta ime universitare, ne jo vetëm që nuk kishim komunikuar ndonjëherë me ndonjë të huaj, por as që e kishim imagjinuar që mund të vinte një kohë që gjuhët e huaja do të na duheshim më shumë sesa për të lexuar libra.

Jeta jonë, e zhvilluar deri aty, brenda lagjes dhe qytetit, me udhëtime shumë të rralla jashtë vetë qytetit për ndonjë javë pushimesh me familjen apo ndonjë rast krejt të veçantë, si dasma ose vdekje të afërmish diku gjetkë, u spostua, sa hap e mbyll sytë, në detin e paanë të lirisë e të mundësive që s'i kishim menduar kurrë dot më parë. Mes barazisë në varfëri, brenda rrethit të një ekonomie të centralizuar në rrugën e së tatëpjetës dhe botës së re të mundësive për t'u ndarë nga varfëria, kaluam fazën e një marrëzie në sensin e kundërt, ku individualizmi ekstrem, në mungesë të institucioneve demokratike, e bënte jetën tonë të ngjante me një kaos e kacafytje për të mbijetuar në mes të detit, pas mbytjes së Titanikut. Ja pra sesi, në një vend kaq të vogël, ne u bëmë dëshmitarë të historisë së madhe të Europës dhe, besomëni, jeta jonë në rrugën e kësaj historie ishte kaq marramendëse sa vendi na dukej nganjëherë i madh sa vetë bota në kaotizmin e në çuditë e transformimit rrënjësor për mirë dhe për keq.



Si e kujtoni fëmijërinë dhe çfarë ëndrrash kishit atëherë?

Fëmijëria në kujtesën time është një oborr i ndritshëm, me kufij të papërcaktueshëm, zërash dhe shijesh të dashura. Kujdesi dhe durimi i gjyshërve e prindërve për t’u dhënë lidhjeve të mia me oborrin sensin e historisë sonë familjare, të vlerave e normave të trashëguara brez pas brezi, mënyrën modeste të të jetuarit janë gurët më të çmuar të fëmijërisë sime. Ashtu sikundër janë kaq shumë të çmuara kujtimet e lojërave të improvizuara në oborrin e mungesave të paimagjinueshme sot nga pikëpamja materiale. Për tim bir, kukulla e Mikit apo një makinë Spider janë pjesë e zakonshme e jetës së tij, për ne, një kukull e bërë me duart tona ishte vetë mrekullia. Kur ngjiteshim lart te fqinji që kishte telefon në shtëpi, për t’u uruar Vitin e Ri kushërinjve jashtë qytetit, ishte si të ngjiteshim në një anije kozmike. Ndërsa sot, kur i shoh fëmijët me sytë ngulur mbi filmat e tyre në ekranin e lpad-it, kam përshtypjen, mbase të gabuar, që, nëse gëzimi ynë atëherë për një lodër a një telefonatë ishte si të të dilnin krahë që të mbanin në ajër për kushedi sa kohë, gëzimi i tyre sot zgjat sa një klik dhe shpejtësia e fashitjes së tij nuk lë vend për t’u ndjerë të sigurt që ata do të dinë t’u gëzohen gjërave të thjeshta të jetës.


Ju keni investuar shumë për arsimimin dhe karrierën tuaj. Sa e vështirë ishte kjo për një grua që vinte nga regjimi komunist?

Studimet universitare unë i përfundova në Fakultetin Ekonomik në Tiranë me rezultate të shkëlqyera, pak vite përpara kolapsit të regjimit komunist. Izolimi ekstrem i deriatëhershëm nuk na kishte mundur asnjë lloj informacioni të paindoktrinar. Tekstet perëndimore për ekonominë ishin mollë e ndaluar. Taksat quheshin forma e rrjepjes së lëkurës së proletariatit nga sistemi kapitalist. Prona private ishte baza e padrejtësisë shoqërore.

Marrja e borxheve nga jashtë shihej si varësi ekonomike, që çonte në gjunjëzim politik. E gjendur në nevojën për t’i paraprirë ndryshimit, kur Rea, vajza ime, ishte vetëm 2 vjeçe e gjysmë, u largova jashtë vendit për më shumë se një vit për studimet master, si e vetmja mënyrë për t’u ballafaquar me boshllëqet e mia. Kalova një shock të vërtetë akademik dhe kulturor. Më pas, u ktheva dhe bëra edhe doktoraturën. Asokohe, punoja në qeveri, në institucionin e ngarkuar me privatizimin e ekonomisë, jepja mësim në universitet dhe njëkohësisht isha e angazhuar në studime me kolege nga vendet e tjera. Ky intensitet, i shoqëruar me ankthin e mbushjes se çdo boshllëku me informacion bashkëkohor, nuk ka reshtur as sot kur ka kaluar më shumë se çerek shekulli, madje është kthyer në mënyrë jetese. Për një grua, ky intensitet është sforcim tejet i madh, në kushtet kur duhet me të njëjtin intensitet të kujdesesh për fëmijën dhe familjen. Kështu ka qenë ky çerek shekulli për shumicën e shqiptarëve të brezit tim, me sfida dhe sakrifica. Megjithatë, po të më pyesnin sot, nëse do të zgjidhja të isha qysh në lindje në një vend të zhvilluar perëndimor apo në Shqipërinë e vogël ish-komuniste për të jetuar më tej këtë transformim epokal, do të zgjidhja pa asnjë hezitim këtë që jetova.

Si e keni përjetuar kohën e regjimit komunist?

Kur më duhet të mendoj për këtë, gjithnjë më kujtohet gjyshi, që nuk e jetoj dot lirinë. Pastaj, më shkon mendja tek gjyshja dhe prindërit, që e përjetuan lirinë në prag të pensionit dhe tranzicionin e jetuan si një hije që u pengonte frymën në çdo hap. Ndërsa kur je fëmijë dhe shkollar, vështirësitë e familjes, në një sistem ku të gjithë janë të varfër, perceptohen pak dhe kalohen lehtë. Më të rriturve jeta u projektohej si gatishmëri për luftë me armikun, sakrificë për sovranitetin e atdheut, përpjekje për familjen nën një tavan shumë të ulët mundësish objektive drejt rritjes së mirëqenies. E pata dhe unë pjesën e së rriturës në



atë periudhë, kur nisi të më brejë shqetësimi mbi realitetin e lirisë së kufizuar. Prindërit shqiptarë në tërësi nuk harronin kurrë t'i këshillonin fëmijët, që të vegjël, se s'duhej të ankoheshin jashtë shtëpisë për mungesat e çfarëdollojshme, por kjo përçe vetëkontrolli niste e shpohej në ballafaqimin e arsyes me realitetin dhe, për mua, kjo kohë përkoji me periudhën e fundit të komunizmit, duke më dhënë mundësinë të jetoj rrugën drejt fundit të iluzioneve.

Vajzat, sapo kalonin të tetëmbëdhjetat, ishin preja e mundshme e shkesëve që ndërmjetësonin martesat e pilotuara nga prindërit dhe të afërmit ose preja po aq e mundshme e gjykimeve të rrezikshme të njerëzve të partisë mbi moralin e tyre, çka i bënte marrëdhëniet e dashurisë tejet të kujdesshme në sytë e njerëzve. Kryeqyteti ku jetoja unë mund të konsiderohej hapësira më liberale, po një puthje në publik ishte sidoqoftë aq e rrallë, sa unë nuk e kam parë kurrë një të tillë! Në Shqipërinë rurale gjithçka ishte shumë më e vështirë për gruan dhe vajzën, ndonëse duhet thënë, nga njëra anë, se përpjekjet e regjimit në atë që quhej “emancipimi” i gruas ishin të mëdha, po të kemi parasysh shoqërinë e mbyllur patriarkale të paraluftës, ku gruaja jetonte në izolim social dhe kishte statusin e gjithëpranuara të garantueses së riprodhimit të jetës e kujdesit për fëmijët dhe shtëpinë. Nga ana tjetër, emancipimi komunist i gruas ishte njëkohësisht edhe defeminilizimi, deri në sterilitet, i trupit të saj në art, muzikë, fotografi. Barazia e gruas me burrin paraqitej në veshjet që i fshihnin hiret femërore, në kostumet e njëjta të punës në fabrikë, në krahët muskulozë të grave që punonin në arat e kooperativës apo në qëndrimin e ngrirë të këngëtareve, që s'mund të kishin as funde mbi gju e as pantallona në skenë.

Si arritët të dalloheshit e të ndiqnit ëndrrat tuaja, si grua vizionare?

Unë nuk e di nëse duhet ta pranoj përcaktimin tuaj për mua si një grua vizionare dhe këtë e them jo për modesti, por sepse, sipas meje, për ta mbajtur këtë përcaktim, duhet të pranosh se je njësoj me ato gra që e kanë bërë botën të rrëqethet me fuqinë e vizionit e të vullnetit të tyre heroik. Por, natyrisht, jam një grua që kam pasur gjithnjë ëndrrën e madhe për të qenë e dobishme, jo vetëm për veten, as vetëm për familjen time a për rrethin e njerëzve të dashur, po edhe për shoqërinë e për vendin tim. Nuk e kam parë kurrë këtë dobishmëri si rezultat i një protagonizmi imponues në mjedisin social e, aq më pak akoma, në media. E kam ndjekur ëndrrën time duke u munduar të përgatitem sa më shumë, për të folur sa më saktë kur kërkohet mendimi im dhe, më duhet ta them, fati nuk ka qenë koprrac me mua dhe kjo ma ka bërë më të lehtë të jem ajo që dua.

Kush ka qenë modeli juaj?

Prindërit e mi; për mësimin se asnjë vështirësi e jetës nuk është arsye për të mos qenë njeri me dinjitet dhe se çdo pengesë apo mungesë në jetë mund të kapërcehet me forcën për të dhënë dashuri e me aftësinë për t'iu gëzuar gjërave të thjeshta të jetës.



Çfarë ju frymëzoi të angazhoheshit në shumë projekte për të drejtat e njeriut?

Nevoja për të qenë e dobishme, për të mundësuar për të tjerët gjëra qe s’më mungojnë, për të bërë mirë me aq sa mundem. Sot është një fakt i pamohueshëm që aktivizmi i thujse dy dekadave të para të tranzicionit ka ndikuar në zbutjen e shumë problemeve që nuk gjenin asnjë vëmendje në zyrat e shtetit. Aktivizmi qytetar, shoqëria civile, siç mësuam ta quajmë, ishte një hap përpara institucioneve të një shteti që përpëlitej mes asaj që kishte qenë dhe asaj që donte të ishte. Strehëzat e grave dhe vajzave viktima të trafikimit, themelet e shërbimeve komunitare, modelet e bashkëpunimit të shkollave me komunitetet, mekanizmat e luftës kundër dhunës në familje dhe shumë të tjera janë, së pari, meritë dhe produkt i aktivizmit civil të viteve kaotike te tranzicionit.

Si do e përshkruanit pozitën e gruas shqiptare sot?

Pas një çerek shekulli të mundimshëm, si në një anije mes dallgëve të larta, në një tranzicion të zgjatur, bota e vajzave dhe grave sot ngjan me një medalje me dy anë. Njëra anë është e ndriçuar nga historitë e atyre që ia kanë dalë në mënyrë mbresëlënëse të jenë të suksesshme si politike, administratore, mësuese, mjeke, sipërmarrëse, artiste. Mjafton të përmend këtu që gjysma e kabinetit qeveritar sot në Shqipëri është me gra, po kështu një e katërta e parlamentit shqiptar, më shumë se 40% e linjës së parë të menaxhimit në kompanitë private janë gra, po ashtu edhe shumica në mësuesi dhe në shëndetësi. Por ana tjetër e medaljes është e rënduar nga errësira e historive të vajzave dhe grave që gjenden në kthetrat e diskriminimit e të dhunës së përditshme, qysh prej fëmijërisë e në vazhdim, në një botë ku nënshtrimi i gruas është norme jetese. Është kjo një botë e vjetër që ka rifilluar

të marrë frymë bashkë me lirinë, një sferë e mënjanuar e jetës. ku nuk penetrojnë sytë e kudondodhur të medias, po as fuqia e institucioneve. Janë gra dhe vajza jashtë rrjetës së internetit, jashtë hapësirës së pushtuar nga klikimet e pëlqimet e çastit, që, megjithëse e pafundme, ato nuk i arrin dot. E pyes veten shpesh çfarë do të mund të bënte, si do të mund ta ndihmonte interneti një grua a një vajzë të izoluar matanë kufijve të botës së tij? Si do të mund ta arrinte, ta thithte në rrezen e fuqisë së tij e t’i përçonte përmes saj një mesazh, një shprehje vëmendjeje, një shpresë? Nuk e di, po e ndjej veten vërtet keq, nën peshën e pafuqisë sime për të kuptuar sesi mund të ndriçohet ajo anë e medaljes...

Çfarë mendoni për demokracinë në Shqipëri? Çfarë nënkupton kjo demokraci për gratë?

Demokracia është një fjalë shumë e thjeshtë për ta thënë, po mua më duket shumë e vështirë për t’ia vene si emër një periudhe të historisë si kjo e jona. A mjafton që të ketë zgjedhje të lira për të thënë që jemi në demokraci? Nuk e di, nuk jam e bindur, sepse nuk më duket se, përtej faktit që zgjedhim të lirë, jemi edhe zgjedhës që respektohemi në të drejtat tona, për sa kohë s’kemi ende një drejtësi që funksionon për të gjithë njësoj. Po jo vetëm kaq, sepse ende s’kemi një shtet që të na përgjigjet dhe jo vetëm të na kërkojë. Shkurt, kur s’kemi ende institucione ku shërbimi të jetë uniform dhe impersonal, a mund të themi se kemi një demokraci realisht funksionale?! Megjithatë, ja që ka, përsëri, një anë tjetër edhe kjo medalje, sepse vërtet sa thashë janë, besoj, siç i thashë, po nga ana tjetër kaq shumë gjëra kanë ndryshuar, sa zor të mos gjesh një ngushëllim të shëndetshëm për çka ende duhet të ndryshojë.

Çfarë do të thotë për ju të jesh bashkëshortja e kryeministrit?

Besoj që rrëfimet e publikuara të bashkëshorteve të kryeministrave në shumë vende të tjera, pavarësisht madhësisë apo standardit të jetesës, thonë me fjalë e me ngjarje të ndryshme të njëjtën gjë. Kam lexuar disa prej tyre dhe të duket që shumë prej përjetimeve janë të njëjtat, madje, mua më duket sikur janë rëndom të miat. Sidoqoftë, nëse duhet ta përkufizoj se ç'do të thotë për mua, mund të them me plot gojën që është një nder dhe një peshë e madhe përgjegjësie të mendosh që njeriu në krahun tënd, të cilit i ke dhënë veten e me të cilin ndan barrën e mirëritjes së fëmijëve të tu, është i besuari i shumicës së njerëzve të vendit tënd. Nder, sepse ata kanë besuar të zgjedhurin tënd, por përgjegjësi, sepse karshi tyre detyrimi është po aq i madh, sa më bën gjykatësen më të rreptë të burrit tim.

Si ka ndryshuar jeta juaj pas martesës me të?

Edi është kryeministër sot, por, si dje kur nuk ishte dhe si nesër kur nuk do të jetë, ai është për mua njeriu i dhuntive të rralla, që lidhen me të folurën, të shkruarin, të pikturuarin e të dizenuarin. Unë e quaj veten me fat që jetoj me Edin dhe dy fëmijët tanë të mëdhenj, Gregun e Rean, që të dy të përkushtuar mbas krijimtarisë artistike, sepse jam veshi dhe syri i parë që ndeshet me idetë e me krijimet e tyre. Kjo është një përmasë e posaçme e jetës sonë familjare, ku Edi ka një rol frymëzues dhe ku mua më takon detyra që, herë-herës, t'i zbres të tre artistët me këmbë në tokë!



Cilat janë angazhimet tuaja më të rëndësishme publike si bashkëshortja e kryeministrit?

Kanë qenë jo të paktë ata që nuk besonin që unë do të vijoja aktivitetin profesional njëlloj si më parë dhe që do të mundesha të mos ndryshoja absolutisht asgjë në të përditshmen time. E njëjtarrugëpërnëpunë,parojëeasshofer,tënjëjtëtmiq,pasalltaneteeboshllëqenë komunikim,tënjëjtatpunëzyreeshhtëpie,si më parë. Profili i bashkëshortes së kryeministrit është një zgjedhje personale. Unë kam pasur qysh më parë, pa e menduar se do vihesha ne pozitën për ta zbatuar vetë, pikëpamjen që publikut i duhet protagonizmi i njeriut që ka votuar për kryeministër, jo i gruas apo burrit të të parit të qeverisë. Të gjitha përçapjet për te imituar çiftin presidencial të Shtëpisë së Bardhë janë qesharake për një republikë parlamentare. Nga ana tjetër, ka momente kur mund të thuash diçka me vlerë brenda profilit tënd profesional apo shoqëror dhe, në këto momente, s’ka vend për ngurrim.

Si është dita juaj e zakonshme?

Edi dhe fëmijët thonë që unë jetoj për të punuar, nuk punoj për të jetuar. Fakti është që puna është pasioni im i pashtershëm, por, në këto 3 vitet e fundit, Zaho, djali ynë 3-vjeçar, më ka rrëmbyer si askush e asgjë dhe, kështu, më duhet ta pranoj se, për herë të parë në jetën time profesionale, pasioni për punën ka një pasion konkurrues shumë të fortë. Mëngjeset dhe mbrëmjet e pushtuara nga aroma, përkëdhelitë dhe tingujt e tij, që kthehen ditë pas dite në fjalë e në fjali, janë një magnet i papërballueshëm që më mban më gjatë larg zyrës paradite apo me tërheq e me largon me shpejt nga zyra pasdite.



Cila është ëndrra juaj më e madhe?

Të jetoj ditën kur të mund t’i shoh fëmijët tanë të përmbushur në jetën e tyre, në një botë më të mirë dhe më të paqtë se kjo që kemi.

Çfarë mesazhi do t’u përçonit grave shqiptare dhe grave në të gjithë botën?

Bota sot ballafaqohet me kriza ekonomike, financiare, sociale apo psikologjike të një thellësie të caktuar, ku institucionet, aktorët apo faktorët e progresit teknologjik, që e kanë përthithur pothuaj të gjithë vëmendjen e publikut, nuk japin siguri për qëndrueshmërinë e së nesërmes. Kam përshtypjen se, më shumë sesa vetë krizat sot, është frika e përshkallëzimit të tyre në një botë gjithnjë e më horizontale, qe e rrit eksponencialisht ndjenjën e pasigurisë apo vetmisë te njerëzit. Ja pse besoj që koha e Eleonor Rusveltit, që e quante sfidë të grave konsolidimin e demokracisë, është rikthyer me te gjithë forcën e aktualitetit.